

Milosheviqi arriti kulminacionin e pushtetit mu kur në pjesët e tjera të Evropës, socializmi ishte në kolaps. Ndërsa ai ngazëllehej nga fuqia e nacionalizmit serb, republikat e tjera jugosllave u mërzitën duke i rënë violinës për interesa serbe. Nuk dihet nëse Milosheviqi e dinte se çfarë do të ndodhte, por në të ‘90-at ai kishte mobilizuar shoqërinë serbe aq sa nuk donin t’ia dinin fare për republikat e tjera. Këtë e arriti pjesërisht duke e shtuar kontrollin mbi mediat serbe.

Derisa zëra të pavarur, si gazeta “Vreme”, stacioni televiziv Studio-B dhe radio B-92 arritën të mbije-tojnë në Beograd, Milosheviqi kontrollonte RTV Beogradin dhe ishte bërë burimi i vetëm informacioni politik jo vetëm në Serbi, por edhe në pjesët e tjera të Kroacisë e të Bosnjës të kontrolluara nga forcat serbe. Gjëja e parë që forcat serbe bënin kur merrnin ndonjë territor ishte t’i largonin antenat që transmetonin Sarajevën e Zagrebin dhe i vënin ato që merrnin vetëm TV Beogradin.

Në kohët e konflikteve më të nxehta, rreth 60 për qind e popullatës së Serbisë përcillte vetëm ditarin e RTV Beogradit, ndërsa vetëm dy për qind i lexonin gazetat. Më 1989 kur Franjo Tugjmani publikoi librin “Djerrinat e realitetit historik” që jepte vlerësime shumë më të ulëta për dëmet që pësuan gjatë Luftës II

Fejton: “Pavarësia dhe fati i minoriteteve (1991-1992)” (9)

Lufta duke i kontrolluar mediat

Gjëja e parë që forcat serbe bënin kur merrnin ndonjë territor ishte t’i largonin antenat që transmetonin Sarajevën e Zagrebin dhe i vënin ato që merrnin vetëm TV Beogradin

Botërore dhe krimeve kroate, që ishin të papranueshme për Beogradin, mediat beogradase u vërsulën në, siç e quanin, “demistifikimi i historisë”. Varrezat nga Lufta II Botërore u hapën dhe tregoheshin të mbeturat; përshkruheshin në detaje dhe tregoheshin pamje të torturave dhe gjymtimeve. Tuxhmani quhej “gjenocidist, fashist, pasardhës i liderit ustash, Ante Paveliq”, etj. Ndërkohë që në anën tjetër, Milosheviqi përshkruhej si “i mençur, i palëkundur dhe njeriu që do t’ia kthejë dinjitetin kombëtar popullit serb”. Natyrisht, mediat kroate në Zagreb që kontrolloheshin nga njerëzit e Tuxhmanit, reagonin me të njejtën masë, duke e quajtur Milosheviqin “kopil i Stalinit, plaçkitës banke”, ndërsa Tuxhmani për ta ishte “dinjitoz dhe shtetar i mençur”. Kur kërситi lufta në Bosnjë në vitin 1992, forcat myslimane u bënë “xhihad, muxhahedinë dhe terroristë”. Të gjitha palët shfrytëzonin këto

strategji destabilizuese, por siç thoshte historiani i luftërave mediale, Mark Thompson, “Serbia printe”. Duke marrë parasysh keqinterpretimet e pikëpamjeve të Izetbegoviqit dhe fushatat e paskurpullta të mediave që bënte televizioni serb (që kishte shëmbëlltyrën edhe në Zagreb), do të ishte e lehtë të argumentohej se frikës së serbëve të Kroacisë dhe Bosnjës “iu prenë teshat kat”. Kjo megjithatë mund të mos jetë tërësisht e saktë. Gjatë periudhës socialiste, dallimet nacionale dukej se ishin më pak të shprehura, por vetëdija për dallimet jetonte thellë nën sipërfaqe. Një marrëdhënie ndërtnike sidomos kurrë nuk tejkaluar dhe kjo ishte urrejtja mes serbëve e myslimanëve, sidomos mes serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës. Kjo armiqësi ka histori të gjatë e identifikohej vetvetiu përmes fesë, gjuhës, emrave dhe veshjeve dhe vetëm keqësohej. Në Beograd, shembull, zanatet tradicionale të

shqiptarëve ishin larës rrugësh, hamallë qymyri dhe kjo sugjeron se edhe serbët më të moderuar kishin mendime të ulëta për shqiptarët. Kjo e spjegon pjesërisht se si Milosheviqi ia doli ti bindë serbët për çështjen e Kosovës. Taktikat e tij ngacmuan ndjenjën e rrënjosur racore në kokat e shumë serbëve. Kuptimi i njëjtë i ka ndihmuar edhe Karagjiqit në Bosnjë që t’i bindë serbët që t’i shohin me syrin më të keq Izetbegoviqibn dhe muslimanët. Antagonizmi ndërmjet serbëve dhe kroatëve, që në fakt nuk është aq i rrënjosur sikur ndërmjet serbëve dhe muslimanëve, gjithashtu ka një histori të gjatë, por ai është është zvogluar në Jugosllavinë socialiste. Megjithatë, ka mbetur një donë e tepërtë e mosbesimit që mund të nxitet lehtë deri në ringjallje nga liderët politik për qëllimet e tyre personale. Për këtë Millosheviqi, Tugjamni dhe Izetbegoviqi, bartin barrën e madhe të përgjegjesisë.

Bashkësia ndërkombëtare, e hutuar pas revolucioneve të Evropës Lindore të vitit 1989, bashkimit të Gjermanisë në vjeshtë të vitit 1990, dhe luftës kundër Irakut në pranverë 1991, nuk i ka kushtuar një vëmendje të duhur situatës së përkeqësuar në ish-Jugosllavi, çfarë ajo e meritonte. Në anën tjetër, këto ngjarje kanë inkurajuar evropianët që ta ndiejnë vetën të pozicionuar mirë për të pranuar përgjegjësinë për ruajtjen e stabilitetit në Ballkan. Siq kishte thënë një diplomat evropian, “ Kjo është Ora e evropës, e jo e Amerikës”, ishin pajtuar edhe SHBA-të, të cilat po fillonin të shikonin drejt zgjedhjeve të vijuese peresidenciale më 1992. SHBA-ja nuk synonte të kyqej në gjendjen e pistë në Ballkan, ku çmimi kishte gjasë të dilte mjaftë i lartë dhe i pashpagueshëm për interesat e ulta amerikane. Administrata e Bushit, përsosshmërisht tregonte vullnetin për t’i lënë evropianët që të përballen si të duan me situatën e përkeqësuar në Jugosllavi.

(Nesër: Çka është në të vërtetë koncepti “standardet para statusit” dhe cila është zanafilla e saj? Për se nuk kishin përvojë BE-ja dhe NATO-ja në fillimit të viteve nëntëdhjetë? Pse nervozohej Van den Broek?)

Fejton: “Al Capone: kumbara i nëntokës” (11)

Capone kremton ditën e të dashuruarve

McGurn e kishte bërë një plan të mirë: do ta thërriste Bugs Moranin në një garazh, ku, gjoja, do t’i shiste uiski me çmim të lirë. Pastaj, njerëzit e McGurnit, të veshur me rroba policësh, do të hynin në garazh, gjoja për të bastisur dhe do ta vrisnin Moranin. Plani vërtet ishte i mirë. Mirëpo, e kishte edhe një të metë...

Në Floridën e nxehtë Al Capone e kishte dëgjuar me vëmendje mikun e tij Jack McGurn dhe kishte vendosur ta vriste armikun e vjetër Bugs Moran. Capone i jepte urdhrat nga Florida, ndërsa shef i operacionit në Chicago ishte Jack McGurn. Ky i fundit i kishte angazhuar disa vrasës profesionistë, në mesin e të cilëve edhe John Scalise dhe Albert Anselmi si dhe Fred Burke. Scalise dhe Anselmi kishin qenë dorasit që e kishin bërë shoshë Frank Yalen gjysmë viti më parë. Po ashtu, në ekipin e vrasësve ishin angazhuar edhe Harry dhe Phil Keywell si

dhe Joseph Lolado. McGurn e kishte përpiluar një plan kreativ: do të merrej vesh me Moranin për një gjoja biznes për shitje të uiskit me çmim ideal në një garazh në periferi. Pastaj, njerëzit e McGurnit hynin në garazh me rroba policie, kinse po bënin një bastisje të rastit. Palët u morën vesh që biznesi me uiski të bëhej pikërisht më datën 14 shkurt 1929, në ditën e të dashuruarve, ndryshe të quajtur Dita e Shën Valentinit. Jack McGurni e kishte marrë të dashurën e tij dhe kishte shkuar në një hotel në atë kohë, jo për ta kremtuar ditën e të

dashuruarve, po për të pasur alibi se nuk ka gisht në këtë punë. Në mëngjesin e 14 shkurtit, njerëzit e Bugs Moranit kishin dalë në garazhin e propozuar për të blerë uiski me çmim të lirë dhe i kishin rrudhur krahët kur në garazh kishin hyrë njerëz me uniforma policie. Njerëzit e McGurnit të veshur si policë filluan gjoja ta bastisnin lokalin. Urdhëruan të gjithë të rreshtoheshin në mur, pastaj i kontrolluan dhe u gjetën armë të fshehura në setra. Vetëm disa çaste më pas u hap zjarr nga ana e njerëzve të veshur si policë. Të pesë burrat që ishin mbështetur për muri ranë të goditur nga plumbat. Katër prej tyre kishin ndërruar jetë. I pesti ende nuk kishte lëshuar grahmë. Ishte ky Frank Gusenberg, mik i Moranit që kishte bërë atentat ndaj McGurnit pak kohë më parë.

Garazhi ishte i mbuluar me gjak në të katër anët, ndërsa vrasësit me uniforma policie u larguan që atej pa shumë zhurmë, hipën në veturën e tyre të vjedhur të policisë dhe u zhdukën në horizont. Ishte një plan i përkryer. Pos një detaji. Caku i të gjithë planit, Bugs Moran, nuk kishte qenë në mesin e të vrarëve. Vëllezërit Keywell që ishin në uniforma policie nuk e kishin njohur mirë Moranin dhe njëri nga gangsterët e tjerë u ishte dukur si ai, kështu që kishin filluar me të shtëna. Mirëpo, e vërteta ishte se Moran duhej të arrinte në garazh, por ishte vonuar dhe sapo ishte afruar para garazhit i kishte dëgjuar të



Kështu e kishte shprehur Capone dashurinë e tij në ditën e të dashuruarve, më 1929

shtënat dhe ia kishte mbathur. Policia e vërtetë kishte arritur disa minuta më pas në garazhin e masakrës dhe i kishte gjetur pesë burra të përgjakur, të shtrirë përdhe. Katër prej tyre ishin të vdekur dhe Frank Gusenbergu ende po merrte frymë, ndonëse i kishte njëzet e dy (sic) plumba në trup. “Kush të qëlloi” - e kishte pyetur rreshteri Sweeney. “Askush”, ishte përgjigjur Gusenbergu gjysmë i vdekur. Gusenbergu ka vdekur disa ditë më pas në spital dhe nuk ka treguar asnjëherë se kush e kishte qëlluar për vdekje. Policët e dinin se ky kishte qenë një sulm i organizuar ndaj Bugs

Moranit. E dinin se plani ishte organizuar nga Capone dhe McGurni. Mirëpo, nuk kishin asnjë fakt. Capone kishte alibi në Floridë, ndëra McGurn e kishte alibi të dashurën e tij, me të cilën u martua pak ditë më pas. Mirëpo, as Capone, as McGurn nuk e kishin paramenduar se sa punë e madhe do të bëhej kjo masakra e Shën Valentinit.

(Në numrin e ardhshëm: Sa ishte e madhe puna e Shën Valentinit? Pse presidenti Hoover kërkonte burgosjen e Capones me çdo kusht? Kush ishin dy sicilianët që donin ta tradhtonin Caponen?)

Gangsterë të tjerë të shquar
Maria Licciardi
Maria Licciardi e njohur me nofkën “Pikolina” (E vogla), njihet si shefe e shefave të mafias në Napoli. E lindur më 1951 në një familje vrasësish e mafiozësh dhe e martuar më pas me një mafioz të rryer, prej Marias së vogël pritej që kryente punë grash. Mirëpo, akullin në këtë drejtim e kishte thyer një tjetër femër, Rosetta “Syakullta” Cutolo, e cila u bë shefe e një dege të mafias dhe e shtyu edhe Marian në këtë biznes. Kur vëllai i madh i Marias, Genaro, përfundoi në burg, Maria e mori pushtetin para burrit të saj dhe dy vëllezërve. Maria Licciardi njihet për udhëheqje të prostitucionit dhe kjo me vajza nga Shqipëria. Punonte edhe me drogë. Nën udhëheqjen e saj, mafia e Napolit u bë edhe më violente dhe më e ashpër. Madje, kur një degë e mafias nuk iu bind një urdhri të saj, ajo shpalli luftë kundër të gjithëve. Rreth njëqind gangsterë u vranë me urdhrat e saj. Kjo bëri që policia italiane, e udhëhequr nga prokurori Luigi Bobbio, t’i vihet në gjurmë. Maria Licciardi vendosi të kundërpërgjigjej duke e vrarë Bobbion. Atentati i saj dështoi dhe Bobbio e arrestoi atë dhe 70 njerëz të tjerë që kishin pranuar urdhra prej saj. Është në burg që nga viti 2001. Megjithatë, ajo është femra e parë që ka pasur ndikim të madh në krimin e organizuar dhe është dëshmuar më e pandjenja se të gjithë meshkujt e tjerë në mafia.